



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 5.7.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “MBI TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 15 , pika 1, shkronja “b” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 47, datë 30.06.2010, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Në nenin 6, pika 1, shkronja “a” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*“titujt me maturim të mbetur deri në 1 (një) vit dhe me periudhë të mbetur në maturim jo më pak se 7 (shtatë) ditë.”*

2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**